

## Emergenza Coronavirus - Firenze

### Çfarë mund të bëj? - Përditësuar më 17.03.2020

- Duhet të qëndroni në shtëpi.
- Nuk mund të dilni rrugëve apo në parqe.
- Mund të dilni vetëm për: **Punë**, për **Vizita mjekësore**, dhe për **Nevoja të domosdoshme** si për shembull të bëni pazaret (sa më afër shtëpisë), të ndihmoni familjarët që janë të pamundur për të lëvizur (të moshuarit dhe të sëmurët duke patur kujdes masat e sigurisë, dhe përdorimin e maskës), të nxirrni jashtë për nevojat personale kafshën shtëpiake (sa më afër shtëpisë) ose te veterineri.
- Para se të dilni duhet të keni me vete një **vetëdeklarim** që mund ta gjeni tek faqja e internetit të Ministrisë së Brendshme në adresën:  
<https://www.interno.gov.it/sites/default/files/allegati/modulo-autodichiarazione-17.3.2020.pdf>
- Nëse të ndalojnë kjo deklaratë ju merret nga Forcat e Rendit të cilët **bëjnë verifikimet e duhura për atë çfarë keni deklaruar**.
- Duhet të mbani të paktën **1 metër distancë** nga personat e tjerë.
- Nëse keni temperaturë (37.5 e sipër) qëndroni në shtëpi, shmangni kontaktet me persona të tjerë dhe merni në telefon mjekun tuaj të familjes ose pediatrin. **Mos shkoni në Urgjencë/Pronto soccorso**.
- Për më shumë informacione mbi Coronavirusin mund të telefononi Numrin jeshil të qarkut **800 55 60 60**, shtypni numrin 1, është aktiv nga e hëna në të premte nga ora 9.00 deri më 18.00.

### **KUJDES!!!!**

**Nëse nuk respektoni këto rregulla ndaluese, kryeni një krim**, duke shkelur nenin 650 të kodit penal, që do të thotë “mosrespektimi i një urdhëri të dhënë nga një autoritet”, dhe në rastin më të rëndë rrezikoni në mosrespektimin e nenit 452 të kodit penal që do të thotë “krime me faj kundër shëndetit publik” dhe gjithë veprimet vijuese të afta për të kryer një rrezik për shëndetin publik.

**Rrezikoni arrest deri në 3 muaj, një gjobë prej 206 euro dhe një rregjistrim të krimit në të dhënat personale (casellario giudiziale), duke ju njollosur kështu dhe të dhënat kriminale.**

**MOS HARRO që çertifikata penale (casellario giudiziale) kërkohet në shumë raste dhe zyra të ndryshme si për shembull për punë, për shtetësinë, apo leje qëndrimi pa afat ( carta di soggiorno),...**